



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **FJALA E KREUT TË PREZENCËS - DHURIMI I PAJISJEVE LEXUESE TË PASAPORTAVE BIOMETRIKE**

*28 qershor 2012*

Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,  
Drejtor Nako,  
Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë të kthehem përsëri në Drejtorinë e Policisë së Shtetit Shqiptar për ceremoninë e sotme.

Ky aktivitet është një shembull më shumë i bashkëpunimit të shkëlqyer midis Prezencës së OSBE-së dhe Policisë së Shtetit shqiptar.

Një partneritet i frytshëm, afatgjatë dhe produktiv në disa fusha thelbësore.

Një prej këtyre fushave është menaxhimi i kufirit, ku ne kemi bashkëpunuar me sukses nëpërmjet trajnimeve, ekspertizës dhe ofrimit të pajisjeve të rëndësishme për Policinë e Kufirit dhe Migracionit. Kjo është arsyeja pse jemi sot këtu.

Menaxhimi i kufirit ka për qëllim rritjen e sigurisë së kufirit.

Policia e Kufirit dhe Migracionit ka një rol thelbësor në ruajtjen e sigurisë së Shqipërisë dhe, dua të përmend, edhe sigurisë së vendeve fqinje. Unë i përgëzoj për punën e tyre.

Zonja dhe zotërinj,

Bashkëpunimi ndërkuftar lind natyrshëm nga siguria e kufirit.

Në të vërtetë, OSBE-ja, e përfaqësuar nga Prezenca në Shqipëri, është themeluar pikërisht mbi parimin e bashkëpunimit për siguri. Ne mendojmë se këto janë arsye të mira.

Kjo shpjegon rëndësinë e bashkëpunimit ndërkuftar të policisë me vendet fqinje.

Ky bashkëpunim rrit besimin, ndihmon në luftën e përbashkët kundër atyre që kundërshtojnë ligjin dhe e bën më të sigurt jetën e qytetarëve që respektojnë ligjin.

Kemi parë progres të dukshëm, si për shembull në formën e takimeve të përbashkëta ndërkuftare midis Policisë së Shtetit Shqiptar dhe homologëve të tyre nga Mali i Zi dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Ne i përgëzojmë dhe i inkurajojmë këto përpjekje të përbashkëta. Ato kanë një rëndësi të madhe rajonale.

Shkëmbimi i informacionit dhe praktikave të mira midis profesionistëve të kufirit sjellin një siguri më të madhe dhe një shërbim më të mirë për të gjithë ne, në të dyja anët e kufirit.

Menaxhimi i kufirit ka të bëjë gjithashtu me lirinë e qytetarëve për të lëvizur ligjërisht, për të shkëmbyer njohuri, ide ose thjesht për pushime.

Ky aspekt i menaxhimit të kufirit është thelbësor për prosperitetin rajonal, sepse ka lidhje me kalimin e mallrave dhe të njerëzve, një themel i sigurisë dhe stabilitetit modern, edhe në rajonin e Evropës Juglindore.

Këtu del aspekti i shërbimit: një shërbim profesional korrekt dhe i shpejtë është shumë i nevojshëm për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni.

Balanca e mirë midis garantimit të sigurisë së kufirit, duke lejuar njëkohësisht trafikun ndërkufitar dhe si rrjedhojë lirinë e lëvizjes, duhet gjetur çdo ditë.

Si fillim, garantimi i duhur i sigurisë së kufirit kërkon profesionistë të përkushtuar, me mbështetjen dhe kapacitetet e nevojshme operacionale.

Edhe ndihma e ofruar nga teknologjitë e avancuara është thelbësore në ditët e sotme për një menaxhim modern të kufirit, për t'i bërë ballë kërcënimeve të shumta si krimi i organizuar, duke mundësuar njëkohësisht progresin njerëzor dhe ekonomik që buron nga lëvizja e lirë dhe e sigurt e njerëzve dhe mallrave.

Dhurimi i sotëm i 10 lexuesve optikë të pasaportave biometrike, së bashku me trajnimin përkatës, është një kontribut konkret i rëndësishëm për të përmirësuar edhe më tej operacionet e kryera në mënyrë profesionale nga Policia e Shtetit. Këto pajisje dhe operuesit e tyre do të ndihmojnë në uljen e orëve të pritjes në kufi dhe në ofrimin e një shërbimi më të mirë e të sigurt.

Jam i bindur që ky kontribut vjen në kohën e duhur, nëse marrim parasysh faktin që po afron piku i sezonit turistik të verës 2012.

Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,  
Drejtor Nako  
Zonja dhe zotërinj,

Për Prezencën e OSBE-së është një detyrë fisnike dhe një kënaqësi e madhe të punojë me Policinë e Shtetit Shqiptar në këtë partneritet kaq të mirë.

Së bashku me stafin tim, mund t'ju them se shpresojmë në një bashkëpunim të mëtejshëm të frytshëm.

Më lejoni t'i uroj Policisë së Shtetit sukses në punën e saj në të mirë dhe në shërbim të njerëzve

Ju faleminderit!

**Fund**